

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të :**AC-I-22-0416-A0001***Paditësi/Ankuesi***N B**, fshati Sh, Prishtinë me përfaqësuese avokaten M G, Prishtinë.**Kundër:***E paditura***N.SH “Trasing”** (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-II-21-0022-C0001, të datës 5 korrik 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-II-21-0022-C0001, i datës 5 korrik 2022.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 24 dhjetor 2016, ankuesi ka parashtruar një padi në DHPGJS për mos pagesën e tri pagave mujore nga largimi nga puna në vlerën prej 801.00 euro. Në ankesë theksohet se edhe pse ishte përpiluar lista e punëtorëve të larguar nga puna në të cilën është cekur edhe shuma për tri rroga të fundit mesatare dhe i është dorëzuar të paditurit të parë, i njëjti nuk ka vendosur lidhur me këtë kërkesë. Kërkesa për pagesën e tri pagave për largim nga puna është përsëritur dhe në vitin 2016 dhe atë në maj dhe qershor të vitit 2016. andaj, i njëjti kishte propozuar që të miratohet kërkesëpadija e paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'i paguaj në emër të tri pagave për largim nga puna shumën prej 801.00 euro në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Padisë i kishte bashkëngjitur si provë: një kërkesë për pagesën e 3 pagave të garantuara nga Komiteti i Likuidimit të atëhershëm të datës 10 qershor 2016 dhe vendimin e mbledhjes në mes të të lartshënuarve rreth privatizimit të ndërmarrjes “Trasing” të datës 13 qershor 2005.

Me datë 30 nëntor 2016, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtje në padi në të cilën thekson se paditësi nuk e ka theksuar bazën juridike në të cilën e mbështetë kërkesëpadinë. Paditësi e kishte përfshirë AKP-në si të paditur në rendin e parë dhe është me rëndësi të potencohet se AKP nuk mund të mbahet përgjegjëse lidhur me këtë padi. Në procedurën e likuidimit paditësi nuk kishte parashtruar kërkesë kreditore çka në fakt ka dështuar që të dorëzoj dëshminë e kërkesës brenda afatit ligjor të dhënë si në njoftim prandaj edhe kjo padi konsiderohet e pasafatshme gjë që pretendimet e paditësit mbasin si të papranueshme. AKP respektivisht komisionet e likuidimit apo autoriteti i likuidimit kishte proceduar me të gjitha kërkesat kreditore të dorëzuara në afatin ligjor dhe në përputhje me Ligjin e AKP-së, gjë për të cilën paditësi është shumë mirë, mirëpo lidhur me këtë padi, nuk ka asnjë mundësi ligjore për ndryshime të mëtejshme në listën e kreditorëve. Andaj, e paditura i propozon gjykatës që të hedhet poshtë si e palejueshme kërkesëpadija e paditësit dhe të pezullohet së shqyrtuari padia e paditësit e paraqitur në N.SH, derisa kjo e fundit është në procedurë të likuidimit. Si prova kishte bashkëngjitur njoftimin për fillimin e likuidimit të datës 23 maj 2007 dhe dëshminë e publikimit të njoftimit për fillimin e likuidimit dhe afatin për kërkesa.

Me datë 13 janar 2017, paditësi kishte paraqitur një parashtrësë të cilës i kishte bashkëngjitur një Aktgjykim C-II-16-0522-C0001 të datës 30 qershor 2020, një Aktvendim të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së AC-I-20-0241 të datës 26 maj 2021.

Me datë 26 maj 2021, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me Aktvendimin AC-I-20-0241 kishte konsideruar ankesën e paditësit si të bazuar dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim në shkallë të parë të gjyqtari përkatës, e cila lëndë më tutje në shkallë të parë nga numri që kishte më parë C-II-16-0522 e kishte marrë numrin C-II-21-0022-C0001.

Me datë 24 qershor 2021, AKP-ja kishte paraqitur një përgjigje ndaj urdhrin të gjykatës duke i dorëzuar njoftimin për dorëzimin e likuidimit të ndërmarrjes N.SH “Trasing”, disa fatura, njoftimin për fillimin e likuidimit të shpallur në shtypin ditor “KOHA Ditore”.

Me datë 5 korrik 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-II-21-0022-C0001 kishte refuzuar si të pabazuar padinë e paditësit. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se gjykata kishte shqyrtuar provat që i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe kishte konstatuar se punëtori padinë e tij të ushtruar me datë 24 tetor 2016 për kompensimin e pagave të papaguara të N.SH “Trasing” është parashtruar jashtë afatit ligjor, andaj në rastin konkret padia e tij e ushtruar kundrejt të së paditurës është refuzuar në tërësi si e pabazuar duke iu referuar dispozitës së nenit 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se “kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”. Gjykata vlerëson se në rastin konkret i padituri ka vepruar drejtë kur ka konsideruar padinë e paditësit të ushtruar jashtë afatit ligjor në mbrojtjen e saj. Andaj, gjykata kishte vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me datë 27 korrik 2022, ankuesi kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit të shkallës së parë C-II-21-0022-C0001 të datës 5 korrik 2022, për shkak të verifikimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që ta prishë lëndën dhe t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje ose ta ndryshoj këtë aktgjykim. Në ankesë theksohet se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar nuk i ka marrë parasysh fare sugjerimet e Kolegjit dhe ka vendosur në procedurë të rishqyrtimit njëjtësi është vendosur edhe në procedurën e mëparshme duke mos i marrë parasysh theksimet

e Kolegjit por edhe më tutje vetëm e vetëm parashkrimin e kërkesëpadisë të cilën Kolegji me shumë të drejtë thekson që parashkrim nuk ka dhe që nëse ekziston është bërë në procedurën e gjyqimit dhe nuk ka të bëjë me AKP-në si palë e paditur. Qëndrojnë faktet që kërkesëpadia e paditësit bazohet në të drejtat të cilat i takojnë pas largimit nga puna a jo kompensim në emër të të ardhurave të papaguara, andaj këtu nuk kemi të bëjmë me parashkrim. Duke pasur parasysh këto që u theksuan, ankuesi i propozon Kolegjit të Apelit si më lartë.

Me datë 10 tetor 2022, AKP paraqet përgjigje ndaj apelit në të cilën thekson se përsëritja e argumenteve që janë parashtruar më parë do të ishte e padobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtare i propozon Kolegjit të Apelit të refuzoj apelin si të pabazuar dhe të vërtetoj aktvendimin e ankimuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor andaj duhet të vërtetohet.

Autoriteti i Likuidimit në bazë të njoftimit të shpallur të bashkëngjitur si provë nga AKP-ja në mbrojtjen e saj në shkallë të parë, kishte informuar kreditorët që likuidimi i kësaj ndërmarrje ka filluar me 15 qershor 2006 dhe që kreditorët kërkesat e tyre ndaj N.SH-së mund t'i paraqesin deri me datën **13 gusht 2006**. Ankuesi në rastin konkret nuk kishte parashtruar fare kërkesë para AL. Ndërsa padinë e tij e kishte paraqitur për herë të parë në DHPGJS me datë **24 tetor 2016**, rrjedhimisht pas afatit të përcaktuar me njoftimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me dispozitën e nenit 74 paragrafi 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme (LDHP) theksohet se *“Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke*

parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit... ”.

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur, Kolegji i Apelit vlerëson se paditësi në rastin konkret pa e shterur mundësinë që pas fillimit të procedurës së likuidimit, të paraqesë kërkesën e tij pranë Autoritetit të Likuidimit, e cila kërkesë në rast të refuzimit do të mund të goditej me parashtrësë në DHPGJS-së, kishte paraqitur direkt padi në DHPGJS, çka në rastin konkret, duke e bërë kështu padinë e tij të papranueshme.

Kolegji i Apelit konstaton se shkalla e parë e DHPGJS-së saktë ka vërtetuar se paditësi kishte paraqitur kërkesë jashtë afatit ligjor, për kompensimin e pagave të pretenduara ndaj NSH-së në likuidim, prandaj padia me të drejtë është refuzuar si e pa bazuar.

Kolegji i Apelit vlerëson se AKP-ja mjaftueshëm i ka përmbushur obligimet e saj ligjore për njoftimin e kreditorëve të mundshëm për paraqitjen e kërkesave ndaj NSH-së në likuidim duke e publikuar Njoftimin.

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konsideron që Njoftimi i shpallur për mundësin e dorëzimit të kërkesave në procedurën e likuidimit i ka përfshirë të gjithë kreditorët e mundshëm pa bërë dallim në kreditorët e njohur apo të pa njohur të NSH-së. Prandaj, përgjegjësia për dështimin e paraqitjes me kohë të kërkesës për paga duhet të bartet nga paditësi dhe i njëjti duhet t’i pranoj pasojat ligjore të këtij dështimi.

Sipas nenit 11 të Ligjit për DHPGJS-në, pala e pasuksesshme duhet t’i paguaj shpenzimet procedurale, përfshirë taksat gjyqësore të palës tjetër. Ankuesi në këtë çështje është palë e pasuksesshme, prandaj shpenzimet gjyqësore janë në barrë të tij.

Nga këto arsye ankesa e ankuesit duhet të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Duke u bazuar në të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi në bazë të nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22 mars 2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që vlera e kontestit është më pak se 1000 euro.

Vendosur nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së më 18 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
